

URDHËR
Nr. 14, datë 29.1.2026

**PËR DELEGIMIN E KRYERJES SË DETYRAVE QË KANË TË BËJNË ME
PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të pikës 5, të nenit 21, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; të pikës 2, të nenit 26 dhe germës “i”, të nenit 37, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të pikës 2, të nenit 73, të vendimit të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; të udhëzimit nr. 4, datë 18.6.2021, “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit, dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, si dhe të udhëzimit nr. 7, datë 30.7.2021, “Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, kancelarit, znj. Selvana Gogo, për kryerjen e detyrave dhe nënshkrimin e akteve për të gjitha procedurat e prokurimit pranë kësaj gjykate.
2. Organi i deleguar nuk mund të nëndelegojë këtë kompetencë.
3. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit.
4. Ngarkohet kancelari, znj. Selvana Gogo, për zbatimin e këtij urdhri.
5. Ky urdhër hyn në fuqi më datë 30.1.2026 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYETAR
Mirjan Mustafaj